



**UNIVERSITETI I PRISHTINËS
UNIVERSITY OF PRISHTINA**

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Nr. Prot.: 4143A
Datë: 11/11/2024

Senati i Universitetit të Prishtinës, duke u bazuar në nenin 20, paragrafi 2.4 të Statutit të UP-së, në lidhje me përcaktimin e politikave dhe procedurave për vlerësimin e studentëve dhe mbajtjen e provimeve, në mbledhjen e mbajtur me datë **11.11.2024**, mori këtë:

V E N D I M

Mbi procedurat për vlerësimin e studentëve dhe mbajtjen e provimeve

1. Në zbatim të nenit 114 të Statutit të Universitetit të Prishtinës mbi *Vlerësimin e Studentëve*, obligohet i gjithë personeli akademik në të gjitha njësitë akademike që të aplikojnë „Modulin për vlerësimin e studentëve” të vendosur në Sistemin Elektronik për Menaxhimin e Studentëve (SEMS). Mbështetur në parimet e vendosura të vlerësimit të vazhdueshëm të punës së studentëve, ky modul reflekton vlerësimin e paraparë në syllabusin e lëndëve përkatëse, sipas programit të akredituar. Vlerësimi i vazhdueshëm përmes modulit përkatës në SEMS, bëhet nga personeli akademik për studentët që kanë zgjedhur lëndën përkatëse në SEMS ose bazuar në specifikat e tjera të njësive akademike, që përcaktojnë zgjedhjen e lëndëve dhe grupeve. Vlerësimi i vazhdueshëm fillon sipas dinamikës së përcaktuar në syllabuset e lëndëve dhe përfundon me 30 dhjetor të vitit kalendarik për semestrin dimëror, si dhe 31 maj të vitit kalendarik për semestrin veror. Për zbatimin e këtij moduli do të plotësohet dhe ndryshohet Manuali i Përdorimit, i cili është i vendosur në SEMS.
2. Për vitin akademik 2024/’25, njësitë akademike obligohen që të bëjnë vlerësimin e studentëve për lëndët e vitit dhe semestrin paraprak, para afateve të provimeve të janarit, respektivisht qershorit të vitit 2025. Vlerësimi për këto lëndë do të realizohet përmes „Modulit për vlerësimin e studentëve” në SEMS, ndërsa vendosja e notave përfundimtare për këto vlerësime (në rubrikën *fletëparaqitjet*) do të bëhet më së largu deri më 20 dhjetor 2024, përkatësisht më 10 maj 2025.
3. Njësitë akademike, në përputhje me specifikat e programeve të tyre të akredituara, do të vendosin në mënyrë autonome për numrin e lëndëve të vitit paraprak (por jo më shumë se tri lëndë) për të cilat do të bëhet vlerësimi sipas pikës nr. 2 të këtij vendimi, si dhe do të hartojnë oraret e këtij vlerësimi dhe të vendosjes së notave përfundimtare në SEMS (në rubrikën *fletëparaqitjet*), duke pasur parasysh mbarëvajtjen e procesit të rregullt mësimor. Kësisoj, mundësohet përfundimi me kohë i gjithë procesit të vlerësimit, si dhe sigurohet që studentët të mund të fillojnë paraqitjen e provimeve për lëndët e vitit në të cilin janë regjistruar, brenda afatit të janarit dhe afatit të qershorit 2025.

4. Personeli akademik, bartësit e lëndëve, obligohen që më së largu brenda dy javësh kalendarike nga marrja e këtij vendimi të bëjnë konfigurimet përkatëse të „Modulit për vlerësimin e studentëve”, të kenë të vendosura në SEMS syllabuset e lëndëve, si dhe materialet mësimore (literaturën dhe materialet tjera përcjellëse). Përkritazi me semestrin veror 2025, personeli akademik, bartësit e lëndëve, obligohen që më së largu deri të premtën e javës së dytë të muajit shkurt, të kenë të vendosura në SEMS syllabuset e të gjitha lëndëve që do të ofrojnë në semestrin veror 2025, si dhe materialet mësimore (literaturën dhe materialet tjera përcjellëse).
5. Në përmbushje të nenit 116 të Statutit të Universitetit të Prishtinës mbi afatet e provimeve, njësitë akademike obligohen që të hartojnë kalendarin e vitit akademik 2024/25 për afatet e provimeve, për periudhën e dimrit (janarit), pranverës (qershorit) dhe vjeshtës (shtatorit), më së voni deri më 29 nëntor 2024.
6. Njësitë akademike obligohen që të monitorojnë në vazhdimësi dhe t'i raportojnë menaxhmentit të UP-së, përkritazi me *zbatimin e vazhdueshëm dhe në plotëni të nenit 114 të Statutit të Universitetit të Prishtinës*. Raporti fillestar për semestrin dimëror 2024 duhet dorëzuar më së voni deri të premtën e fundit të muajit nëntor, ndërsa ai përfundimtar deri të premtën e javës së dytë të muajit janar. Raporti fillestar për semestrin veror 2025 duhet dorëzuar më së voni deri të premtën e fundit të muajit mars, ndërsa ai përfundimtar deri të premtën e javës së dytë të muajit qershor. Menaxhmenti në nivel të njësive akademike dhe të UP-së, obligohen që në rast të mos *zbatimit të vazhdueshëm dhe në plotëni të nenit 114 të Statutit të Universitetit të Prishtinës* që të ndërmarin masa të menjëhershme ndaj personelit akademik për mospërmbushjen e obligimeve kontraktuale ndaj Universitetit të Prishtinës.
7. Lidhur me procedurat e vlerësimit të studentëve dhe mbajtjen e provimeve, Senati nxjerr një rregullore të veçantë duke pasur parasysh specifikat e programeve të studimeve.
8. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas miratimit në Senat dhe vlenë deri sa të nxirret një vendim tjetër.

Ky vendim i dërgohet:

1. Arkivit të UP-së;
2. Senatit të UP-së;
3. Njësive akademike të UP-së;
4. Parlamentit të Studentëve.



Prof. Arben Hajrullahu

Rektor i Universitetit të Prishtinës